



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

PUNIME DHE RIPARIM RRUGËSH

Niveli i tretë në KSHK1, referuar nivelit III të KEK²

B4-III-22,

Tiranë, 2022

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	PUNIME DHE RIPARIM RRUGËSH			Kodi B4-III-22
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional në “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK është përgatitja e individëve për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punime dhe riparim rrugësh dhe zhvillimi i personalitetit të tyre për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Punime dhe riparim rrugësh”, Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar dy vitet e para në kualifikimin profesional, “Ndërtim”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK ; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional. – mund të pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimi krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me certifikatën profesionale dhe suplementin e certifikatës profesionale të nivelit të punonjësit të kualifikuar në këtë profil, të cilat njihen në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Ky kualifikim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në sipërmarrje ndërtimi dhe mirëmbajtjeje rrugësh, si punëtor i kualifikuar në punime të rrugëve dhe riparimit të tyre, në njësi të shitjes së materialeve të ndërtimit ose mbas një përvoje pune të vetëpunësohet si sipërmarrës, duke punësuar individë të tjerë në veprimtari të punimit të rrugëve dhe riparimit të tyre.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesionale “Punime dhe riparim rrugësh”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK-së, referuar nivelit IV të KEK (teknik/menaxher) të kualifikimit profesional (njëvjeçar) “Ndërtim” dhe fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	B-II-04-12, B4-III-18,			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Njohuri të përgjithshme të planifikimit, organizimit dhe njohjes me projektin

- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit me teknikët/inxhinierët për projektin;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së terrenit ku do të kryhen punimet;
- Të shpjegojë mënyrën e raportimit të kushteve të pasigurta tek personat përgjegjës, në mënyrë që të parandalohen aksidentet;
- Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit të burimeve të nevojshme njerëzore;
- Të përshkruajë mënyrat e planifikimit të mjeteve, instrumenteve dhe materialeve e punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së sinjalistikës së përkohshme dhe të barrierave për të parandaluar hyrjen e trafikut në zonat e mirëmbajtjes dhe riparimeve në rrugë;
- Të përshkruajë mënyrën e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e sigurimit të burimeve të nevojshme (ujë dhe energji) për kryerjen e punimeve;
- Të shpjegojë teknikat e pastrimit dhe sistemimit të veshjeve, veglave dhe vendit të punës para, pas dhe gjatë punës;
- Të shpjegojë format dhe rëndësinë e raportimit të eprorët për punën e kryer.

Njohuri të përgjithshme të skicimit

- Të përshkruajë vizatimet e punimeve në rrugë dhe veprave të artit që përbëjnë fletët e projekt-zbatimit të;
- Të përshkruajë vizatimet e fletëve konstruktive të projekt-zbatimit të veprave inxhinierike të rrugëve dhe veprave të artit;
- Të interpretojë shenjat dalluese të përdorura në projekt zbatim;
- Të interpretojë plane rilevimi të ndryshme;
- Të interpretojë detaje, sipas përmasave të dhëna në planimetri aksiale, profile gjatësore dhe tërthore për rrugë dhe vepra arti;
- Të interpretojë skicat e rjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e vepra arti, si dhe shenjat dalluese të përdorura.
- Të interpretojë profilin e vendit, kur jepet plani me izoipse;
- Të interpretojë shkallët grafike gjatësore dhe tërthore;
- Të interpretojë shkallën e pjerrësisë dhe të masë pjerrësinë e një vije;

Punime për ndërtimin e rrugës

- Të shpjegojë rrugët, tipet, llojet, elementet përbërëse të tyre (traseja, nënshtresat, mbishtresat, karrexhatat, sinjalistika horizontale e vertikale, gjelbërimi dhe ndriçimi);
- Të interpretojë ndërtimin e gjurmës së rrugës në plan së bashku me profilin gjatësor, profilet tërthore dhe tabelën e vëllimeve të dherave;
- Të përshkruajë hapat për piketimin e rrugëve të kategorive të ndryshme në terren;

- Të shpjegojë hapat e punimeve të modinimit të trasesë së rrugëve për gjurmim dhe mbushje të saj bazuar në kuotat e dhëna në projektzbatim, sipas kategorive të ndryshme;
- Të rendisë hapat e punimeve të gjurmimit dhe mbushjes së trasesë së rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të shpjegojë shtresat e trupit të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat për punimet e ndërtimit të veprave të artit në rrugë;
- Të përshkruajë hapat për punimet e ndërtimit të kasonetës, nënshtresës dhe themeleve të rrugëve të kategorive të ndryshme.

Punime gjurmimi

- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me topografin për piketimet;
- Të shpjegojë mënyrën e bashkëpunimit me manovratorët e makinerive për punimet e gjurmimit të trasesë së rrugës;
- Të shpjegojë mënyrën e heqjes së dherave dhe materialeve të panevojshme;
- Të përshkruajë metodat e gjurmimit për pusetat;
- Të përshkruajë metodat e gjurmimit për kunetat;
- Të përshkruajë metodat e gjurmimit për themelet e mureve dhe veprave të artit;
- Të përshkruajë metodat e gjurmimit në pjesët e deformuara të rrugës.

Punime shtresash në trupin e rrugës

- Të përshkruajë hapat për nivelimin dhe ngjeshjen pas gjurmimit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e bashkëpunimit me manovratorin për realizimin e shtresave;
- Të shpjegojë teknikën e kontrollit të kuotave të shtresave;
- Të shpjegojë hapat për punimet e ndërtimit të shtresave të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikën e lagjes me ujë të shtresave të stabilizantit;
- Të përshkruajë teknikën e ngjeshjes së çdo shtrese sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Të përshkruajë metodën e vendosjes së piketave në sipërfaqen që do asfaltohet;
- Të shpjegojë teknikën e spërkatjes me prajmer para asfaltimit;
- Të përshkruajë metodën e matjes së temperaturës së asfalt-betoneve;
- Të përshkruajë hapat për punimet e shtrimit me asfaltbeton të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikën e ngjeshjes së asfaltbetonit të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikën e ndërtimit të kunetave dhe kanaleve në rrugë;
- Të përshkruajë teknikat e prerjeve të copëzave e pjesëve të ndryshme të asfaltit me frezë, sharrë dhe makineri.

Konstruksione mbajtëse në rrugë dhe vepra arti

- Të rendisë llojet e konstruksioneve mbajtëse në rrugët dhe veprat e artit;
- Të interpretojë skica të thjeshta të elementëve konstruktivë prej guri, druri dhe metali.
- Të interpretojë skica të thjeshta të elementëve konstruktivë prej betoni të armuar, të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura;

Punime në veprat e artit, tombinot, pusetat dhe kanalet

- Të përshkruajë tombinot dhe pusetat në rrugë të kategorive të ndryshme: llojet tipat, elementet përbërëse të tyre dhe funksionin e secilit element;
- Të përshkruajë kanalet në rrugë të kategorive të ndryshme: tipat, elementet përbërëse të tyre dhe funksionin e secilit element;
- Të përshkruajë urat, mbikalimet, nënkalimet, elementet përbërëse të tyre, funksionin e secilit element në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikat për punimet e ndërtimit të tombinove dhe pusetave në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikat për ndërtimin e kanaleve në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikat për ndërtimin e urave, mbikalimeve, nënkalimeve.

Punime për ndërtimin e mureve pritëse/mbajtëse dhe skarpatave

- Të shpjegojë arsyet e ndërtimit të llojeve të ndryshme të mureve sipas materialit përbërës, kushteve të terrenit apo kërkesave të projektit;
- Të përshkruajë llojet e mureve pritëse/mbajtëse në rrugë të kategorive të ndryshme sipas teknologjisë përkatëse;
- Të përshkruajë teknikat për ndërtimin e mureve pritëse/mbajtëse, mënyrat e ndryshme të mbrojtjes së tyre në funksion të terrenit, klimës dhe formacioneve të tokës në zonën ku ndërtohet rruga.

Punime të trotuareve

- Të përshkruajë trotuaret, tipet, llojet, elementet përbërëse të tyre;
- Të përshkruajë teknikën e kontrollit të kuotave të shtresave;
- Të përshkruajë teknikën e thyerjes dhe copëtimit të gurëve që përdoren në trotuare;
- Të përshkruajë teknikën e nivelimit të shtresave të trotuareve;
- Të përshkruajë teknikën e shtrimit dhe nivelimit të shtresës së betonit poshtë bordurave të trotuareve;
- Të përshkruajë teknikën e vendosjes së bordurave të trotuareve;
- Të përshkruajë teknikën e ndërtimit të kunetave;
- Të përshkruajë teknikat për ndërtimin e pusetave me materiale të ndryshme në trotuare;
- Të përshkruajë teknikën e shtrimit të trotuareve me materiale të ndryshme.

Punime për sinjalistikën rrugore dhe gjelbërimin

- Të shpjegojë elementët mbrojtës, funksionin, mënyrat e vendosjes dhe rëndësinë e tyre për funksionimin normal të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë sinjalistikën në rrugë të kategorive të ndryshme: tipat, llojet, elementet përbërëse të tyre, funksionin e secilit element;
- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes të elementeve mbrojtëse në rrugë;
- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes së gjelbërimit në rrugë;
- Të përshkruajë teknikat dhe hapat për punimet e sinjalistikës në rrugë të kategorive të ndryshme sipas projektit;
- Të përshkruajë hapat për instalimin e sinjalistikës së përkohshme;
- Të përshkruajë hapat për instalimin e shtyllave të ndriçimit;
- Të përshkruajë hapat për instalimin e tabelave rrugore;
- Të përshkruajë hapat për vijëzimin rrugor me makineri apo me dorë;

- Të përshkruajë teknikat dhe hapat për punimet e elementeve mbrojtëse në rrugë të kategorive të ndryshme sipas projektit;
- Të përshkruajë llojet e gjelbërimit të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat për parapërgatitjen e terreneve për gjelbërim.

Punime për mirëmbajtje dhe riparime rrugësh

- Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve të kategorive të ndryshme sipas kushteve teknike të shfrytëzimit të tyre;
- Të përshkruajë teknikat e mirëmbajtjes së sinjalistikës dhe elementeve mbrojtëse të rrugëve të kategorive të ndryshme sipas kushteve teknike të shfrytëzimit të tyre;
- Të përshkruajë teknikat e pastrimit të urave, tombinove dhe kanaleve anësore të rrugës me krahë ose me makineritë e pastrimit;
- Të përshkruajë teknikat e pastrimit të vazhdueshëm të bimëve të rrëzuara, shkurreve, gurëve nga sipërfaqja e rrugës;
- Të përshkruajë rëndësinë e identifikimit të rrjeteve inxhinierike nëntokësore për të shmangur dëmtimet e tyre gjatë punimeve të riparimeve në rrugë;
- Të përshkruajë hapat për punimet e riparimit në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë teknikat e prerjes, gjurmimit të sipërfaqes së dëmtuar të rrugës, trotuareve;
- Të përshkruajë teknikat e mbushjes me çakëll ose stabilizant në pjesët e dëmtuara në rrugë e trotuar;
- Të përshkruajë teknikat e riparimit të asfaltimit në sipërfaqet e dëmtuara;
- Të përshkruajë teknikat e riparimit të veprave të artit në rrugë;
- Të përshkruajë teknikat për riparimin e sinjalistikës rrugore.

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të gjurmimeve;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të pjerrësisë së rrjetit inxhinjerik;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të ndërtimit të rrugëve e trotuareve sipas specifikimeve teknike;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve të ngjeshjes sipas piketave në kuotat e caktuara për çdo shtresë rruge;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të veprave të artit në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të përshkruajë mënyrat e verifikimit të cilësisë së punimeve të kanaleve në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë për përgatitjen e betoneve sipas markës së dhënë;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të spërkatjes me prajmer gjatë gjithë sipërfaqeve të rrugës;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të shtrimit të materialit të asfaltbetonit;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të sinjalistikës në rrugë e trotuare të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve paraprake për gjelbërim në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të riparimit të rrugëve e trotuareve të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;

- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të mirëmbajtjes së rrugëve e trotuareve të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të mirëmbajtjes së sinjalistikës dhe elementeve mbrojtëse në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike.

Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës

- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit në fushën e punimeve, mirëmbajtjes dhe riparimeve në rrugë e trotuare;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit tatimor, kodit të punës e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjitha elementet kryesore të saj;
- Të shpjegojë rolin e institucioneve financiare në biznes;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme të biznesit;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të përshkruajë rëndësinë e planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit të punës së kryer dhe urdhrave të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara ndaj klientëve;
- Të përshkruajë përgatitjen e raporteve periodike të punës për aktivitetet e zbatuara;
- Të shpjegojë tregun lidhur me çmimet dhe cilësinë e materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
- Të japë shembuj të llogaritjeve të kostove të materialeve, vëllimeve dhe shërbimeve të kryera;
- Të përshkruajë përgatitjen e ofertave për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të identifikojë blerjet e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit në kohë të bashkëpunëtorëve për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë rëndësinë e marrjes së informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të parimeve të punës në grup;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave dhe hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Të japë shembuj të udhëzimeve nga bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të teknologjive të reja të komunikimit;

- Të shpjegojë teknikat e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët, duke përdorur komunikimin e duhur;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim.

Rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të përshkruajë planin e sigurisë dhe koordinimit të veprës inxhinierike (rrugës dhe veprave të artit);
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit për çdo lloj punimi në rrugë e trotuare;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimi të manualeve e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të përshkruajë sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të planit të evakuimit në raste emergjence;
- Të përshkruajë rëndësinë e identifikimit dhe raportimit tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të interpretojë situatat potenciale të rrezikshme, elementet që paraqesin rreziqe individuale dhe kolektive profesionale;
- Të listojë mjetet, materialet, detyrat dhe zonat me rrezikshmëri, sipas rregullave të sigurimit teknik lidhur me rekomandimet specifike për sigurinë dhe shëndetin;
- Të përshkruajë kërkesat e rregulloreve të sigurimit teknik lidhur me instalimet elektrike, të internetit, telefonisë, kanalizim-ujësjellës, sinjalistikës si dhe në rastin e punimeve me makineri elektrike;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullores përkatëse gjatë përdorimit të lëndëve plasëse, lëndëve djegëse, gaz, ajër i presuar etj.;
- Të përshkruajë kushtet e montimit dhe qëndrueshmërisë të skelave që përdoren për të punuar në lartësi në veprat e artit;
- Të interpretojë informacionin e dhënë në paketimin e materialeve që përdoren për çdo lloj punimi të rrugëve e trotuareve;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës;
- Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të përshkruajë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve të rrezikshme sipas standardeve;
- Të përshkruajë përdorimin në mënyrë racionale të energjisë dhe materialeve;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste emergjence apo pandemie.

Materialet

- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e shtresave për rrugë e trotuare të kategorive të ndryshme si dhe për mirëmbajtje e riparim;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e veprave të artit në rrugë;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e montimit dhe lidhjes të armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;

- Të përshkruajë materialet që përdoren për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në vepër të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e mureve pritëse e mbajtëse në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e riparimit në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë materialet që përdoren për punimet e rrjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e trotuare.

Mjetet, instrumentet dhe makineritë e punës

- Të përshkruajë instrumentet gjeodezike matëse-niveluese për teknikat e punimeve të rrugëve të kategorive të ndryshme, të veprave të artit, e punimeve të mureve mbajtëse/ pritëse në rrugët dhe punimeve për riparimit e tyre;
- Të përshkruajë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të veprave të artit në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të mureve mbajtëse /pritëse në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të riparimit të rrugëve e kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë mjetet e punës, instrumentet gjeodezike e matëse-niveluese për teknikat e punimeve të rrjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e vepra arti;
- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të materialeve, mjeteve të punës, instrumenteve gjeodezike e matëse-niveluese në vendin e punës.
- Të listojë llojet e makinerive që përdoren për prodhimin e bazave të asfalto-betoneve, betoneve etj.;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e gërmimit në rrugë të kategorive të ndryshme e vepra arti;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e kunetave në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e shtrimit dhe nivelimit në rrugë të kategorive të ndryshme e vepra arti;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e ngjeshjes së shtresave në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e mbrojtjes së skarpateve në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për vendosjen e mbrojtësve anësore në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të listojë llojet e makinerive e pajisjeve ndihmëse të teknologjisë bashkëkohore të cilat përdoren në mirëmbajtjen e rrugëve të kategorive të ndryshme.
- Të përshkruajë llojet e makinerive e pajisjeve ngritëse e transportuese, specifikiisht për punimet dhe riparimet në rrugë e vepra arti.

SHPREHI PROFESIONALE

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Njohuri të përgjithshme të planifikimit, organizimit të punës dhe njohjes me projektin

- Të konsultohet me teknikët/inxhinierët për projektin;
- Të kryejë njohjen e terrenit ku do të kryhen punimet;
- Të kryejë raportimin e kushteve të pasigurta tek personat përgjegjës; në mënyrë që të parandalohen aksidentet;
- Të planifikojë burimet të nevojshme njerëzore;
- Të planifikojë mjetet instrumentet dhe materialet e punës;
- Të dallojë elementet e sinjalistikës provizore rrugore;
- Të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve të punës;
- Të sigurojë burimet e nevojshme (ujë dhe energji) për kryerjen e punimeve;
- Të pastrojë dhe sistemojë veshjet, veglat dhe vendin e punës para, pas dhe gjatë punës;
- Të raportojë te eprorët për punën e kryer.

Njohuri të përgjithshme të skicimit

- Të vizatojë sipas shkallëve grafike gjatësore dhe tërthore;
- Të lexojë planimetrinë aksiale, në planin me izoipse;
- Të lexojë profilin gjatësor dhe profilet tërthore të trasesë së rrugës;
- Të lexojë shkallën e pjerrësisë së trasesë nga piketa në piketë;
- Të vizatojë planimetrinë aksiale, në planin me izoipse;
- Të vizatojë profil gjatësor dhe profilet tërthore të trasesë së rrugës
- Të lexojë vizatimet e fletëve të projektzbatimit të rrugës;
- Të vizatojë detaje sipas përmasave të dhëna në planimetri dhe prerje për rrugë e vepra arti;
- Të lexojë skicat e rrjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e vepra arti, si dhe shenjat dalluese të përdorura.

Punime për ndërtimin e rrugës

- Të lexojë specifikimet për çdo punim të elementeve të rrugëve, tipet, llojet, elementet përbërëse të tyre (traseja, nënshtresat, mbishtresat, karexhatat, sinjalistika horizontale e vertikale, gjelbërimi dhe ndriçimi);
- Të kryejë punime për piketimin e rrugëve të kategorive të ndryshme në terren;
- Të kryejë punime të modinimit të trasesë për gjërmim dhe mbushje të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të kryejë punimeve të gjërmimit dhe mbushjes së trasesë së rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të kryejë punimet për shtresat e rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të kryejë punimet e ndërtimit të kasonetës, nënshtresës dhe themeleve të rrugëve të kategorive të ndryshme;

Punime gjërmimi

- Të bashkëpunojë me topografin për piketimet;

- Të bashkëpunojë me manovratorët e makinerive për punimet e gërmimit të trasesë së rrugës;
- Të bashkëpunojë në heqjen e dherave dhe materialeve të panevojshme;
- Të ndjekë hapat e gërmimit për pusetat;
- Të ndjekë hapat e gërmimit për kunetat dhe kanalet;
- Të ndjekë hapat e gërmimit për themelet e mureve;
- Të ndjekë hapat e gërmimit në pjesët e deformatuara të rrugës.

Punime shtresash në trupin e rrugës

- Të ndihmojë në nivelimin dhe ngjeshjen pas gërmimit;
- Të bashkëpunojë me manovratorin për realizimin e shtresave;
- Të ndihmojë në kontrollin e kuotave të shtresave;
- Të kryejë punime ndërtimi të shtresave të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të pastrojë dhe lagë me ujë shtresat e stabilizantit;
- Të kryejë ngjeshjen e çdo shtrese sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Të bashkëpunojë në vendosjen e piketave në sipërfaqen që do asfaltohet;
- Të bashkëpunojë në spërkatjen me prajmer para asfaltimit;
- Të matë temperaturën e asfaltobetove;
- Të ndjekë hapat për punimet e shtrimit me asfalt-beton të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të zbatojë punimet e ndërtimit të shtresave të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të bashkëpunojë në punimet për ngjeshjen dhe shtrimin me asfalt-beton të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të kryejë punime për ndërtimin e kunetave dhe kanaleve në rrugë;
- Të presë copëzat e pjesëve të ndryshme të asfaltit me frezë, sharrë dhe makineri.

Konstruksionet mbajtëse në rrugë dhe vepra e arti

- Të dallojë llojet e konstruksioneve mbajtëse në rrugë dhe vepra arti;
- Të vizatojë skica të thjeshta të elementëve konstruktivë prej betoni, betoni të armuar, të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura;
- Të vizatojë skica të thjeshta të elementëve konstruktivë prej tulle, guri, druri dhe metali.

Punime në veprat e artit, tombinot, pusetat dhe kanalet

- Të lexojë fletën e projektit dhe specifikimet teknike për tombinot dhe pusetat në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të lexojë fletën e projektit dhe specifikimet për kanalet në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të lexojë fletën e projektit dhe specifikimet për urat, mbikalimet, nënkalimet dhe elementet përbërëse të tyre, në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të zbatojë teknikat për punimet e ndërtimit të tombinove dhe pusetave në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të zbatojë teknikat për ndërtimin e kanaleve në skarpatat në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të kryejë punimet për ndërtimin e urave, mbikalimeve, nënkalimeve dhe urave të varura në rrugë të kategorive të ndryshme;

Punime për ndërtimin e mureve pritëse/ mbajtëse dhe skarpateve

- Të lexojë specifikimet teknike për çdo punim të mureve pritëse/mbajtëse në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të lexojë fletë projekti me detaje të ndryshme të mureve mbajtëse sipas materialit përbërës, kushteve të terrenit;
- Të kryejë punime për ndërtimin e mureve pritëse/ mbajtëse, mënyrat e ndryshme të mbrojtjes së tyre në funksion të terrenit, klimës dhe formacioneve të tokës në zonën ku ndërtohet rruga.

Punime të trotuareve

- Të lexojë fletët e projektit dhe specifikimet teknike për çdo punim të trotuareve kategorive të ndryshme;
- Të nivelojë shtresat me inerte të trotuareve;
- Të nivelojë shtresat me beton të trotuareve;
- Të zbatojë teknikat e thyerjes dhe copëtimit të gurëve që përdoren në trotuare;
- Të zbatojë teknikën e shtrimit dhe nivelimit të shtresës së betonit poshtë bordurave të trotuareve;
- Të vendosë bordurat e trotuareve;
- Të zbatojë teknikat në ndërtimin e kunetave dhe kanaleve;
- Të zbatojë teknikat në ndërtimin të tombinove dhe pusetave me materiale të ndryshme;
- Të kryejë shtrimin e trotuareve me materialeve të ndryshme.

Punime për sinjalistikën rrugore dhe gjelbërimin

- Të kryejë punimet për elementët mbrojtës sipas funksionit, mënyrave të vendosjes dhe rëndësisë së tyre, për funksionimin normal të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të kryejë punimet për sinjalistikën në rrugë të kategorive të ndryshme në varësi të tipit, llojit, elementëve përbërës të tyre, funksionin e secilit element;
- Të realizojë vendosjen e elementeve mbrojtëse në rrugë;
- Të bashkëpunojë në realizimin e gjelbërimit në rrugë;
- Të zbatojë teknikat dhe hapat për punimet e sinjalistikës në rrugë të kategorive të ndryshme sipas projektit;
- Të zbatojë hapat për instalimin e sinjalistikës së përkohshme;
- Të zbatojë hapat për instalimin e shtyllave të ndriçimit;
- Të zbatojë hapat për instalimin e tabelave rrugore;
- Të zbatojë teknikat për vijëzimin rrugor me makineri apo me dorë;
- Të zbatojë teknikat dhe hapat për punimet e elementeve mbrojtëse në rrugë të kategorive të ndryshme sipas projektit;
- Të zbatojë hapat për parapërgatitjen e terreneve për gjelbërim.

Punime për mirëmbajtje dhe riparime rrugësh

- Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve të kategorive të ndryshme sipas kushteve teknike të shfrytëzimit të tyre;
- Të zbatojë teknikat e mirëmbajtjes së sinjalistikës dhe elementeve mbrojtëse të rrugëve të kategorive të ndryshme sipas kushteve teknike të shfrytëzimit të tyre.
- Të zbatojë teknikat e pastrimit të urave, tombinove dhe kanaleve anësore të rrugës me krahë ose me makineritë e pastrimit;

- Të zbatojë teknikat e pastrimit të vazhdueshëm të bimëve të rrëzuara, shkurreve, gurëve nga sipërfaqja e rrugës;
- Të identifikojë rjetet inxhinierike nëntokësore për të shmangur dëmtimet e tyre gjatë punimeve të riparimeve në rrugë;
- Të zbatojë hapat për punimet e riparimit në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të zbatojë teknikat e prerjes, gjurmimit të sipërfaqes së dëmtuar të rrugës, trotuarëve;
- Të zbatojë teknikat e mbushjes me çakëll/ stabilizant në pjesët e dëmtuara në rrugë e trotuar;
- Të zbatojë teknikat e riparimit të asfaltimit në sipërfaqet e dëmtuara;
- Të zbatojë teknikat e riparimit të veprave të artit në rrugë;
- Të zbatojë teknikat për riparimin e sinjalistikës rrugore.

Sigurimi i cilësisë së punimeve

- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të gjurmimeve;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të pjerrësisë së rjetit inxhinjrik;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të ndërtimit të rrugëve e trotuarëve sipas specifikimeve teknike;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të ngjeshjes sipas piketave në kuotat e caktuara për çdo shtresë rruge;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të veprave të artit në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të përkrahë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të kanaleve në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë për përgatitjen e betoneve sipas markës së dhënë;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të spërkatjes me prajmer gjatë gjithë sipërfaqeve të rrugës;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të shtrimit të materialit të asfalt-betonit;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të sinjalistikës në rrugë e trotuarë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve paraprake për gjelbërim në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të riparimit të rrugëve e trotuarëve të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të mirëmbajtjes së rrugëve e trotuarëve të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike;
- Të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së punimeve të mirëmbajtjes së sinjalistikës dhe elementeve mbrojtëse në rrugë të kategorive të ndryshme sipas specifikimeve teknike.

Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës

- Të zbatojë konceptet bazë të legjislacionit në fushën e punimeve, mirëmbajtjes dhe riparimeve në rrugë e trotuarë;
- Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të zbatojë sipërmarrjen me të gjitha elementet kryesore të saj;
- Të ushtrorë aktivitetin duke njohur rolin e institucioneve financiare në biznes;
- Të zbatojë rregulloren e brendshme të biznesit;

- Të zbatojë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të ruajë/arkivoj dokumentacionin e punës së kryer dhe urdhrave të punës;
- Të regjistrojë të dhënat për faturat dhe ofertat e lëshuara ndaj klientëve;
- Të përgatisë raporte periodike të punës për aktivitetet e zbatuara;
- Të ndjekë tregun lidhur me çmimet dhe cilësinë e materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
- Të kryejë llogaritje të kostove të materialeve, vëllimeve dhe shërbimeve të kryera;
- Të përgatisë oferta për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të kryejë blerjet e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme;
- Të zbatojë teknikat e marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të zbatojë metodat e zhvillimit profesional;
- Të informojë në kohë bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja;
- Të zbatojë aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të informohet mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të zbatojë rregullat dhe hierarkinë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Të bashkëpunojë për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Të zbatojë teknologjitë e reja të komunikimit;
- Të zbatojë teknikat e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët, duke përdorur komunikimin e duhur;
- Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim.

Rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së shëndetit në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë planin e sigurisë dhe koordinimit të veprës inxhinierike (rrugës dhe veprave të artit);
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit për çdo lloj punimi në rrugë e trotuarë;
- Të përdorë manualët e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
- Të zbatojë hapat për dhënien së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të zbatojë sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence;
- Të raportojë tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të identifikojë situatat potenciale të rrezikshme, elementet që paraqesin rreziqe individuale dhe kolektive profesionale, në planin operativ të sigurisë;
- Të identifikojë mjetet, materialet, detyrat dhe zonat me rrezikshmëri, sipas rregullave të sigurimit teknik lidhur me rekomandimet specifike për sigurinë dhe shëndetin;

- Të zbatojë kërkesat e rregulloreve të sigurimit teknik lidhur me instalimet elektrike, të internetit, telefonisë, kanalizim-ujësjellës, sinjalistikës si dhe në rastin e punimeve me makineri elektrike;
- Të zbatojë rregulloren përkatëse gjatë përdorimit të lëndëve plasëse, lëndëve djegëse, gaz, ajër i presuar etj.;
- Të zbatojë kushtet e montimit dhe qëndrueshmërisë të skelave që përdoren për të punuar në lartësi në veprat e artit;
- Të zbatojë informacionin e dhënë në paketimin e materialeve që përdoren për çdo lloj punimi të rrugëve e trotuareve;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes, grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të zbatojë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve të rrezikshme sipas standardeve;
- Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet;
- Të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste emergjence apo pandemie.

Materialet

- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e shtresave për rrugë e trotuare të kategorive të ndryshme si dhe për mirëmbajtje e riparim;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e veprave të artit në rrugë;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e montimit dhe të lidhjes së armaturës së hekurit të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për përgatitjen e betonit dhe punimet e betonimit (hedhjes në vepër të betonit) të elementeve konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e mureve pritëse e mbajtëse në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e riparimit në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren për punimet e rrjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e trotuare.

Mjetet, instrumentet dhe makineritë e punës

- Të përzgjedhë instrumentet gjeodezike matëse-niveluese për teknikat e punimeve të rrugëve të kategorive të ndryshme, të veprave të artit, e punimeve të mureve mbajtëse/pritëse në rrugët dhe punimeve për riparimit e tyre;
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të veprave të artit në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të mureve mbajtëse/pritëse në rrugët e kategorive të ndryshme;
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e punës për teknikat e punimeve të riparimit të rrugëve e kategorive të ndryshme;

- Të përzgjedhë mjetet e punës, instrumentet gjeodezike e matëse-niveluese për teknikat e punimeve të rjetit inxhinierik (elektrik, telefonik, të internetit, të kanalizimeve e furnizimit me ujë, të sinjalistikës etj.) në rrugë e vepra arti;
- Të sistemojë materialet, mjetet, instrumentet gjeodezike e matëse-niveluese në vendin e punës.
- Të bashkëpunojë me manovratorët e makinerive që përdoren për prodhimin e bazave të asfalto-betoneve, betoneve etj.;
- Të bashkëpunojë me manovratorët e makinerive që përdoren për punimet e gjermimit në rrugë të kategorive të ndryshme e vepra arti;
- Të bashkëpunojë me manovratorët e makinerive që përdoren për punimet e kunetave në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të bashkëpunojë me manovratorët e makinerive që përdoren për punimet e shtrimit dhe nivelimit në rrugë të kategorive të ndryshme e vepra arti;
- Të bashkëpunojë me manovratorët e makinerive që përdoren për punimet e ngjeshjes së shtresave në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për punimet e mbrojtjes së skarpateve në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë llojet e makinerive që përdoren për vendosjen e mbrojtësve anësore në rrugë të kategorive të ndryshme;
- Të listojë llojet e makinerive e pajisjeve ndihmëse të teknologjisë bashkëkohore të cilat përdoren në mirëmbajtjen e rrugëve të kategorive të ndryshme;
- Të përshkruajë llojet e makinerive e pajisjeve ngritëse e transportuese, specifiku për punimet dhe riparimet në rrugë e vepra arti.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.